

Turk, elhamdulillah!\*

Olsi Jazexhi

Rreth vitit 1994, kur nisa të shkoj për herë të parë në xhami, më kujtohet si tani sesi një ditë në xhaminë e sapondërtuar të Kombinatit, shoh një grup të rinjsh që po talleshin me një plak të moshuar. Plaku i cili, nëse nuk gaboj ishte me origjinë nga zonat e Pogradecit, u thoshte djemve që vinin në xhami se ne “muslimanët” jemi “turq”. Sipas plakut, “turk” ishte edhe vetë profeti Muhamed. Djemtë e xhamisë ma rrëfyen rastin e plakut, për të më treguar sesa “i rrjedhur” ishte xhaja që nuk e dinte ende që ne jemi “shqiptarë”. Dhjetë vite më vonë, në 2004, kur punoja në Kavajë, një kavajas që donte t’i tregonte një turku që ishte me mua sesa të afërt janë kavajasit me turqit, i thotë që: *ne në Kavajë themi Kavajë e kuqe, rremë Stamolli*. Pas një viti, në muajt e dimrit 2005, Myftiu i Shkodrës me të cilin po bisedoja mbi situatën në qytetin e tij, ndër të tjera më tregoi një anekdotë të vjetër shkodrane, ku tregohej sesi në kohët e vjetra një burrë kur shkon te myftia e pyet: *Myfti efendi sa sharte ka Tyrqinia?* Duke mos kuptuar dot kuptimin e fjalës *Tyrqini*, e pyes myftiun – po *Tyrqini* çfarë do të thotë? Ai më tregon që në kohët e vjetra, në Shqipëri, njerëzit me fjalën *Tyrqini* kanë kuptuar Islamin, ndërsa me *turk* - muslimanin. Konfuzioni im për të kuptuar dallimin ndërmjet “turkut” dhe “shqiptarit”, dhe Islamit dhe Turqinisë është shtuar edhe më shumë gjatë një vizite që bëra në Prizren në vitin 2005. Në qytetin e Prizrenit, të cilin historiografia shqiptare pretendon të jetë një nga bastionet ku ka lindur shqiptarizmi, popullata fliste çuditërisht turqisht. Ama kur shumë turqishtfolës pyeten se çfarë janë, shumë përgjigjen “shqiptarë”.

I intriguar për të kuptuar zanafillën e ndasisë së “shqiptarit” me “turkun” dhe, për më tepër, duke dashur të kuptoj se çfarë ka qenë “turku” në imagjinatën e popullatave shqipfolëse përpara krijimit të identitetit modern shqiptar, nisa ta bëj këtë shkrim, dhe fillimisht vendosa të kërkoj për definicionet e fjalës turk që ne përdorim sot. Burimi më i mirë i informacionit për të kuptuar definicionet e fjalës turk mendova se do të ishin fjalorët e gjuhës shqipe. Në fjalorin e Shqipes se Sotme, botimi i vitit 2002 për fjalën “Turk” gjeta

---

\* Për formësimin e këtij shkrimi më duhet të falenderoj Artan Puton me të cilin kam konsultuar këtë shkrim disa herë.

shpjegimet që shumica e shqiptarëve i pranojnë si korrekte. Këtu: *Turk-u* është = 1. *banor vendas i Turqisë ose ai që e ka prejardhjen nga Turqia*. 2. *dikush që lidhet me turqit, që është karakteristik për turqit ose që është krijuar prej tyre; i Turqisë ose i turqve*.<sup>1</sup> Megjithatë në fjalorin e Gjuhës Shqipe të vitit 1980, të botuar nga Akademia e Shkencave për fjalën Turk gjeta këto kuptime: 1. *banor vendas i Turqisë ose ai që e ka prejardhjen nga Turqia*. Dhe: 2. *vjet. Mysliman*.<sup>2</sup> Ndërsa në Fjalorin e Orientalizmave në Gjuhën Shqipe të Tahir Dizdarit gjeta këto shpjegime për fjalën Turk: ‘1. *Banues i Turkisë aziatike e ballkanike*. Dhe: 2. *Tue qenë se konvertimi në Islam i shumicës së madhe të popullit tonë ndodhi nën pushtimin osman, në çdo krah të vendit të konvertuemit u thirrën turk, turq, turkë, turkeshë, turkinë, tue mos pasë tjetër vështrim as qëllim veçse të cilësimit të besimtarit musliman, rrjedhimisht në bashkëfetarësi me pushtuesin*.’ Me pas autori jep një seri përdorimesh të fjalës turk gjatë kohëve të parambretërisë. Disa shembuj janë: “*Mo, në je turk!*” Dibër. “*Në je turk e bir turkut, mos, se stë ka hije*”. Shkodër. “*Kush është turk n’Muhamenë / Të mos lshoj dervenë*” VD 30. “*More turk i Perëndisë:/ (M)Syna derën e xhamisë/...*” – nga një vajtim në Shkrel, ke HD. “*Djali i dadës në kosh turk/ Këto dy faqe mos mi puth!/ Nkosha turk me imanë/ sti la faqet pa ti ngranë!*” Malësi e Gjakovës.’<sup>3</sup>

Në kërkimet e mia për të kuptuar ndasinë e “turkut” nga “shqiptari” unë kam hasur një numër të madh shkrimesh, letrash dhe artikujsh të cilat edhe pse për shqiptarin e ditëve të sotme mund të duken të pabesueshme, çuditërisht vijnë deri në mesin e shekullit të XX dhe muslimanin shqiptar e tregojnë si “turk”. Një gjë të këtillë hasa edhe përpara disa kohësh në shkrimin ‘Lot Gjakut’ të botuar në revistën Hylli i Dritës në 1913 nga Gjergj Fishta. Këtu autori thotë ndër të tjera që ‘*Turqit e rii tuj pas baa bee me i qitë faret kryekput Shqyptarët kso jetet, me zemër qi u dha guzimi i pamarrshëm i Evrejve dhe framasoneve*’, kërkonin që të bëjnë hatanë ndaj “shqyptarëve”. Por, siç duket, në Shqipërinë e vitit 1913 fjala “turk” mund të keqkuptohej. Për këtë arsye, në fund të shkrimit, Fishta vetëmbrohet para lexuesit duke vënë në dukje që: *nën emënin Tyrk ktu do t’merret vesht rodi, fisi i Turqve t’Azisë, e jo muslimant, ndjekësit e fees muhamedane*.<sup>4</sup>

<sup>1</sup> Fjalor i Shqipes se Sotme, Akademia e Shkencave e Shqiperise, Instituti i Gjuhesise dhe i Letersise, Botim i dyte i ripunuar, Toena, Tirane, 2002, 1374.

<sup>2</sup> Fjalori i Gjuhes se Sotme Shqipe, Akademia e Shkencave te Shqiperise, Tirane, 1980, 2042

<sup>3</sup> Tahir N. Dizdari, Fjalor i Orientalizmave në Gjuhën Shqipe, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Organizata Islame për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (ISESCO), Tiranë, 2005, 1054-1056

<sup>4</sup> Gj. Fishta, Lot Gjakut, Hylli i Dritës, Nr. 1, 1913, 21

Edhe pse në ditët tona për shumë shqiptarë krahasimet e *muslimanit* me *turkun* mund të duken të habitshme, shumë shkrime nga Shqipëria e para vitit 1912, por edhe më pas, tregojnë të kundërtën. Mënyra se si muslimanët e kanë imagjinuar veten por edhe janë imagjinuar, ka qënë e ndërtuar mbi bazën e konceptit ymetik të Islamit, ku në rastin konkret “turku” dhe “Turqëria”, që në termat e sotëm ne do t’i përkthenim si *muslimani* dhe *Islami*, në të kaluarën duket të kenë formuar bashkësinë e imagjinuar të *miletit islam* të Perandorisë Osmane, ku i pari i saj ishte sulltani-kalif i Stambollit dhe pjesë e milletit të tij ishin “turqit” që përbënin Perandorinë Turke. Në librin ‘Komunitetet e Imagjinuara’, Benedikt Anderson-i vë në pah forcën e religjionit për të konstruktuar komunitete të imagjinuara, siç është rasti i Ymetit Islam apo në rastin shqiptar, “Tyrqinia”, të cilat ndërtohen në përgjithësi nëpërmjet mediumit të gjuhës së shenjtë dhe të shkruar.<sup>5</sup> Në rastin e shqiptarëve, mes të cilëve definicioni kombëtar u konsolidua pas krijimit të shtetit-kombëtar, mentaliteti i *miletit osman* ku identiteti formësohej jo mbi gjuhën, hartën dhe mitet e sajua kombëtare të mëvonshme, por mbi përkatësinë fetare, duket të ketë qënë mënyra dominuese e klasifikimit shoqëror. Rasti i Kosovës, ku në vitin 1954 Esad Mekuli boton poezinë e tij të famshme, *Turk elhamdulila*,<sup>6</sup> tregon vështirësinë e madhe që projekti shqiptarizues ka patur për të hedhur rrënjë në Kosovë, të cilës i mungonte shteti-kombëtar, dhe ku “shqiptari” sipas poezisë më lart e quan veten *turk elhamdulila – turk, shyqyr Zotit*.

Problemi i tranzicionit të të imagjinuarit të vetes nga të qënit pjesë e mileteve shumëshekullore “turke”, “rum orthodoxe” dhe “kështenë katolike” në të qënit “shqiptarë”, ka prodhuar një varg betejash identitare dhe xhepa rezistence gjatë historisë së Shqipërisë të shekullit të kaluar, të cilat janë demonstruar në historinë tonë që nga Mirdita dhe Malësia e Madhe, në Shqipërinë e Mesme dhe në jug të vendit. Këto beteja ndeshen edhe sot në krahina të ndryshme të Shqipërisë. Edhe pse historianët dhe politikanët shqiptarë këto lëvizje shpesh i kanë shpjeguar si “tradhëtare”, “haxhiqamiliste”, “obskurantiste”, “grekofile” etj, pas tyre ka qëndruar në fakt beteja ndërmjet imagjinimit

<sup>5</sup> Benedict Anderson, *Imagined Communities*, Verso 1991, 12 – 13

<sup>6</sup> *Turk elhamdulila*, nga vellimi Brigjet, Prishtina: Rilindja 1981, 72. Ja disa vargje nga poezia:

*Turku me shpatë ka pre- / Evropa dridhet, ushton.. / Në Kosovë luftuem dhe ne / Liri, kush s’të don?!*

*Me shpatë, me zjarm sundoi- / Me shekuj liri s’kemi pa. / Tirani mbi ne gërmoi: / Ja turku, elhamdulila!*

*Fenë me kombësi e njisoi, / Muslim e turk- s’ka da. / Deshti edhe emnin t’na harroi:/ - Je turk, elhamdulila!*

*Dhe gjuhën tonë e ndaloi, / Kush turqisht s’flet fe s’ka. / Ashtu, thane, Zoti urdhënoi: /- Je turk, elhamdulila!*

*Je turk, je Turk!- kanë shti / Shqiptarin me shekuj, pa da, / e një ditë ndër ne u ndi:/- Jam turk, elhamdulila!*

modern të kombit të ndërtuar mbi baza shekullare dhe etnike, që shteti ynë adoptoi nga Rilindja, dhe atij osman të bazuar mbi bazën e milletit fetar.

Për të shpjeguar më mirë këtë rrugë të gjatë të udhëtimit identitar të “turqve” dhe “kaurëve” të Vilajeteve Osmane dhe kthimit të tyre në ‘shqiptarë’, mendoj se libri i parë më të cilin mund ta ilustrojmë këtë tranzicion është “Bleta Shqiptare” e Thimi Mitkos.<sup>7</sup> Në botimin e saj në vitin 1878, Mitko, tregon që qëllimi i botimit të këtij libri është ruajtja e *‘këtyre këndimeve albanologjike... që t’u ipet një shkak e shtyrje bashkatdhetarëve shqiptarë për të kulturuar edhe studiuar gjuhën e tyre amtare që... edhe këta të civilizohen edhe të kenë njësoj vleftë me vëllezërit e tjerë të tyre ellenofonë.’* Me përmbledhjen e tij, Mitko kërkon të ndërgjegjësojë shqiptarët për kombësinë e tyre, duke iu mësuar gjuhën, në mënyrë që ata të mësohen me mendime greke dhe *‘të zënë rrënjë ne ay patriotismi grek’*, të dojë *‘kombësin e ti greke’* dhe të *‘fshtet’te mendjen e zembrën e ti jo ne Sllavët e në Italjanët po më tepër ne mëma Greqi, dyke sjellë ndër ment gjyshërit e ti Epiriotët e Maqedonët, bashkë kombëtarët e ti në Greqi të lirë...’*<sup>8</sup>

Megjithë dëshirën modernizuese të Mitkos, e cila mëton që “shqiptarin” ta bëjë patriot “grek”, do të shohim se “shqiptari” në një pjesë të mirë të këngëve të Mitkos nuk e ka parë veten si “grek”, por rrallë si “shqiptar”, dhe në shumicën e rasteve sipas ndasisë së tij fetare në “turk” dhe “kaur” apo sipas ndasisë krahinore si “gegë”, “toskë” etj. Në këngët e Luftës së Himarës, psh., kur muslimanët luftuan kundër të krishterëve mund të lexosh vargje si *‘turq dhe të kërshterëtë / të gjithë të parëtë / bejërat, agallarëtë/ të gjithë bujerëtë.’*<sup>9</sup> Të njëjtën gjë kuptojmë edhe në këngën e Ali Pashës kundër Himarës ku lexojmë *‘Nga Nivica Koçodhutë/ Q’është i pari ndë vulë/ që pa të s’bënetë punë / as ndë turq as ndë kahurë’*.<sup>10</sup> Ajo që të bie në sy në poezitë e mbledhura nga Mitko, është se këtu emri “shqiptar” përdoret pothuajse në të gjithë rastet për të klasifikuar të krishterët që luftojnë kundër muslimanëve, dhe përjashtim bëjnë rastet kur shqiptarët luftojnë kundër turqve.<sup>11</sup> Çfarë bie në sy në poezitë e Mitkos është që klasifikimet që personazhet e këngëve të tij kanë me shumicë, janë *turq* dhe *kaurë*, *gegë* dhe *toskë*, *arapë*, *raja*, *halldup*, *mirditorë*, *lap*, *shkodranë*, etj. Për më tepër, në këngët që Mitko sjell nga Gegëria fjala “shqiptar” mungon totalisht. Në poezitë e “Bletës...”, por edhe në të tjera të mbledhura nga Mitko, duket që

<sup>7</sup> Mitko Thimi, *Bleta Shqiptare* e Thimi Mitkos, Vjene 1924

<sup>8</sup> Ibidem, hyrja

<sup>9</sup> Mitko, *Bleta Shqiptare*, 114

<sup>10</sup> Ibid 124

<sup>11</sup> Shembull Kenga e Ibrahim Pashe Misirliut. 156

“shqiptarët” veten e tyre kanë klasifikuar si *turq* dhe *kaurë*, dhe në Gegëri “shqiptari” pothuaj nuk ekziston! Në këngët e mbledhura nga Tirana psh. ku flitet për ndërtimin e Urës së Beshirit, populli e quan veten turk dhe kaur në poezinë që ja dedikon bamirësit Ali Beshiri:

*Ali Beshiri prej Tirane / na shpëtoi shpyrtë, shpëtoi xhanë / Beshirit i rrut'e bija /  
kodit urë me rubija / Ti moj urë, e mjera urë / që mban këlgere, mban gurë /  
shkojnë turq, shkojnë kaurë / të sosurë s'kanë kurrë / Beshiri u lint me dekë /  
mbenë trupat nëpër detë.*

Po ashtu në një poezi tjetër nga kjo zonë lexojmë sesi besimtarët adresojnë njëri tjetrin:

*‘Çohij turq, haj ne xhami  
na ka ardh një hoxh'i ri.’<sup>12</sup>*

Imagjinimi i vetes si turk lexohet edhe në poezitë e sjella nga Shkodra ku lexojmë këto rreshta në poezinë e luftës me Hafës Pashën:

*Gjithë thërrasim ‘ja Mahbub’  
Jena turq, e faj stë kena  
sulltan Mahmut banu vakuf  
gjithë robt’ e Zotit jena.’<sup>13</sup>*

Qemal Haxhihasani, i cili ka studiuar vjershat e Mitkos është i mendimit se fjalët *Shqipëri*, *shqyphtar* dhe *halldup*, Mitko i ka shtuar vetë nëpër vjersha për t’u dhënë atyre një përmbajtje patriotike.<sup>14</sup>

Por, përdorimi i “turkut” për të treguar muslimanin shihet edhe në përmbledhjen e Kasem Taipit “Zana Popullore” të botuar në 1933, në një kohë kur ‘shqiptarizimi’ ishte politikë e kohës dhe qeveria kishte nxjerrë një seri ligjesh për të shkatërruar trashëgiminë turke dhe rum orthodhokse në vend, dhe ‘shqiptarizuar’ si Komunitetet Fetare (Kishën Ortodokse, Komunitetin Musliman, Syni dhe Bektashi), ashtu edhe jetën publike me reformat e saja gjuhësore, ligjore etj. Megjithatë ajo që bie në sy në këngët e Taipit është

<sup>12</sup> Qemal Haxhihasani, *Thimi Mitko*, Tirane 1981, 336

<sup>13</sup> Mitko, 218

<sup>14</sup> Cituar sipas Jane C. Sugarman (1999), *Imagining the Homeland: Poetry, Songs, and the Discourses of Albanian Nationalism*, Ethnomusicology, 425

sërisht prania e fortë në këngët e popullit e të quajturit të vetes *turk* e *kaur* dhe jo *shqiptar*. Shqiptari duket sikur nis të shfaqet në përmbledhjen e Taipit pas vitit 1878, në kohë të Itifakut (Lidhjes) së Prizrenit. Por, edhe këtu *shqiptari* nuk i shpëton dot *turkut* dhe shpesh thotë që jam “turk” safi. Një shembull është poezia e vjetit 1878 ku gjejmë fjalën shqiptar të ndërthurur me turk:

*Elif – E na u fillue  
në kambë u çue Shqiptarija...  
Sin – Se kenkan safi Turq  
vendin kaurrit nuk ja lëshojnë.*<sup>15</sup>

Përshkrimin e *shqiptarit musliman* si *turk* në ngjarjet e vitit 1878 ne e gjejmë edhe në poezitë e sjella nga Xhaferr Belegu në librin e tij mbi Itifakun e Prizrenit, ku ndasia ndërmjet katolikëve mirditorë dhe muslimanëve lexohet në klasifikimet që poeti i bën muslimanit si *Turki* ndërsa katolikëve si *Mri* apo *Fandë*:

*More pash pasha i Maxharit / Nuk i jam i mbretit, jam i kralit /  
Fjal i coj patër Marianit/ Me i mbledhun krent e Fandit /  
Krent e Fandit me bajrak/ Se në kresun ç’do me i ran  
Morë hoxhë façezi / Pa ferman si del në ushtri/  
Hem imam hem plak Haxhi/ Besa Mria s’bahet turki /  
Ka lidh besën me shtat krali / Shtat Krali ka zan në dorë/  
Çon asqerin nëpër borë / Nëpër borë e nëpër shi /  
Nuk bahet Mria turki.*<sup>16</sup>

Një rast interesant që vlen për t’u përmendur në përmbledhjen e Kasem Taipit është edhe *Kanga e Luftës së Junanit* që u drejtua nga Gani Beg Toptani në 1897 kundër Greqisë. Këtu lexojmë që banorët e Shqipërisë së Mesme, të cilët ishin në ballë të luftës kundër Greqisë, luftonin për Turqini:

*Iptida u nis nizaja  
urumi mrrini në Gjirit  
Sebep ban Bari – telqaja*

<sup>15</sup> Kasem Taipi. Zana Popullore (Kange Popullore), vol I, Shkoder, 1933, 112 – 113

<sup>16</sup> Xhafer Belegu, Lidhja e Prizrenit e veprimet e sajë, 1878 – 1881, Tirane 1939, 44

*për me dalë Turqinija në dritë,*

Në asnjë vend nuk lexohet për *shqiptarë*, edhe pse lufta u drejtua nga shqiptarët dhe beu i Tiranës.<sup>17</sup> Edhe në poezinë që Taipi sjell nga Shkodra për këtë luftë po ashtu lexojmë për *turq* dhe *kaurë*. Për *turq* dhe *të kështenë* flet edhe Gjergj Fishta në poezinë që ai i dedikon lumturisë që Hyrrijeti (Shpallja e Kushtetutës) në Stamboll ka shkaktuar në Shkodër në vitin 1908:

*Rreh burija e trumpeta*

*Turk e kështenë në kambë janë çue*

*Padishahit ju rritët jeta*

*Sot mbretnin e paska pshtue...*<sup>18</sup>

Por, çuditërisht fjala “Shqiptari” zëvendëson atë “Turqëri” në Këngën që i dedikohet vrasjes së Gani Beg Toptanit nga sadrazemi osman, në Stamboll në 1902. Në këngën kushtuar Xhiut të Fajës – atentatorit që Esat Pasha dërgoi në Stamboll për të marrë hak për Gani Begun disa vite më vonë, lexojmë:

*Xhija i Fajës një Kruetanë*

*Shqiptaris ja la një namë*

*Xhija i Fajës zog petriri*

*Esad Pasha e porosi...*

*Xhija i Fajës një Kruetanë*

*në Stamboll na ka lanë namë.*<sup>19</sup>

Këtë ndryshim identitar që ndodh në këngët rreth Gani Begut, më mirë se kushdo, ndoshta e shpjegon Hafiz Ibrahim Dalliu, i cili tregon që njerëzia nisi me çel sytë ‘*kah viti 1895 kur filluen me ardhë në Tiranë gazetatat që botoheshin në Tyrqi prej zhon tyrqish dhe prej shqiptarësh të arratisun.*’ Vrajsa e Gani Begut në 1902 dhe dalja e këngës së Ganiut ndoshta rreth 10 vite pas rënies së parë në kontakt të elites intelektuale tiranase me qarqet xhonturke dhe shqiptariste, dhe mediat e tyre, ndoshta ka qenë shkaku i ndryshimit të mënyrës së imagjinimit nga *Turqëri* për në *Shqiptari*, që përmendet në poezinë më lartë.

---

<sup>17</sup> Taipi 137

<sup>18</sup> Ibid. 204 – 205

<sup>19</sup> Ibid. 174

Zëvendësimi i konceptit imperial të “Turqinisë”, e cila në këtë kohë “tironsave” iu transmetohej nëpërmjet mediumit të xhamisë, administratës, shkollave dhe gjuhës së saj osmane, me regjionalizmin e “Shqiptarisë”, i cili ju eksportua disa prej intelektualëve dhe bejlerëve tiranas nëpërmjet asaj që Benedikt Anderson-i do të quante kapitalizmi i shtypshkrimit (print-capitalism), i cili, nga ana e tij, fuqizoi gjuhën e rrugës apo të lokalitetit, dhe më pas në aspektin afatgjatë ndërtoi idenë e lashtësisë – një aspekt shumë i rëndësishëm në formimin e idesë subjektive të kombit-<sup>20</sup> ishte ndoshta faktori kryesor i këtij tranzicioni imagjinar.

Megjithatë, siç Hafiz Dalliu rrëfen në kujtimet e tija, në Tiranë, deri në vitin 1908, shumica e popullit ishte indiferente karshi identitetit të tij. Një pjesë e popullit ishin mbështetës të qeverisë së Abdylhamidit. Dhe vetëm një pakicë donte ndryshimin e qeverisë dhe mendohej “me përhapë idenë kombëtare”, dhe këta quheshin shqiptarë.<sup>21</sup> Kjo pakicë sipas shumicës së dëshimtarëve të kësaj kohe, ishin në përgjithësi intelektualët dhe bejlerët, të cilët u ndikuan nga idetë e nacionalizmit i cili në këtë kohë kishte nisur të penetrojë Perandorinë Osmane nga perëndimi. Por siç vë në dukje Mustafa Kruja, nëpër provinca dhe aty ku nuk kishte intelektualë, siç ishte rasti i Shijakut, nuk kishte “shqiptarë”.<sup>22</sup> Sipas Hafiz Dallit i cili mburret me numrin e madh të “shqiptarëve” në Tiranë përkundër qyteteve të tjera, personat që ishin “shqiptarë” në atë kohë ishin gjithësej rreth 150 vetë në një qytet prej pesëmbëdhjetë mijë banorësh. Dhe, për më tepër, ata që ishin konvertuar në “shqiptarë” në shumicën e rasteve ishin bejlerët, ndërsa kundër tyre qëndronin qeveritarët, oficerët, myderrizat, tregtarët dhe pasanikët.<sup>23</sup>

Pranimi i konceptit krahinor të “shqiptarit”, si të ndryshëm nga koncepti imperial i “turkut”, ka qënë një problem i madh për banorët e vilajeteve shqipfolëse të Perandorisë Osmane. Historiani Kemal Karpat rreshton një numër faktorësh që çuan muslimanët e Perandorisë, dhe në veçanti ata të Ballkanit, që të quajnë veten e tyre “turq” dhe të refuzojnë identitetet krahinore dhe etnike. Disa nga faktorët që ai përmend janë kërcënimi që ata ndjenin nga nacionalizmat ballkanikë, identifikimi i muslimanëve me shtetin dhe modernitetin osman dhe impaktin që projekti osmanizues kishte për të njësuar muslimanin me turkun, dhe për më tepër inspirimi që imazhi i turkut kishte për intelektualët vendas, të

---

<sup>20</sup> Anderson. 44 – 45

<sup>21</sup> H. Ibrahim Dalliu, *Patriotizma në Tiranë*, 1995. 21

<sup>22</sup> Mustafa Kruja, “*Shqiptari*” i 1912 e *shqiptarizma në qarkun e Durrsit*, Shejzat – Shtatuer – Dhetuer 1972, fq. 317

<sup>23</sup> Ibid. 28



cilët, tek turku shihnin heroin e osmanizmit dhe Islamit.<sup>24</sup> Këto janë disa nga arsytet që Karpati tregon si të rëndësishëm në faktin që çuan shqiptarin, i cili nuk dinte asnjë fjalë turqisht, që të pranojë klasifikimin etnik turk, pa marrë parasysh sesa mund të donte ai që të distancohej nga turku etnik.<sup>25</sup> Por në anën tjetër, dhe në kundërshtim me rrymën popullore, pati edhe shumë intelektualë nga provincat shqipfolëse, siç është rasti i *rilindasëve* tanë, që kërkuan të ndajnë muslimanin nga turku.

Mungesën e shqiptarizmit gjatë fundshekullit të XIX dhe fillimshkullit të XX në mesin e popullit e vë në dukje edhe Mehdi Bej Frashëri, i cili tregon që në Shqipëri shumica e ortodoksëve të jugut ndjeheshin *grekë*, dhe në Shkodër katolikët dhe muslimanët, moralisht dhe shpirtërisht ishin thjeshtë *turq* edhe *kaurë*.<sup>26</sup> Vështirësia që intelektualët nacionalistë kishin për të bërë popullin e tyre të vetëquhej shqiptar, sipas Hafiz Dalliut duket të ketë qenë më e madhe sesa e lidhur thjeshtë me përkatësinë fetare të individit. Në shumë raste ne kuptojmë që njerëzit nuk kanë kuptuar edhe se çfarë do të thotë fjala “shqiptar”. Hafiz Dalliu tregon për shembull që në vitin 1908, kur Refik Bej Toptani që ishte kryetar i Xhemijetit (Xhon Turqve) të Tiranës dhe një nga pak propagandistët e shqiptarizmit, nisi të shpërndajë disa abetare me gërma latine në qytet, ai u përball me rebelimin e popullit, hoxhallarëve, oficerëve, qeveritarëve, tregtarëve dhe pasanikëve. Habia e popullit të Tiranës me “shqiptarin” ishte aq e madhe, sa që ata nuk dinin as se çfarë janë “shqiptarët” dhe për këtë pyetën myftinë e qytetit, i cili ju dha fetva që të mos flasin me shqiptarët pasi ata janë njerëz të nxitur nga shejtani.<sup>27</sup> Propaganda kundër të mësuarit të gjuhës shqipe me gërma latine dhe të qenit shqiptar ishin aq të mëdha sa që hoxhallarët thonin: *Shqipja të ban kaurr, të ban me marrë për grue i vëllai motrën, të ban me shembë teqe e xhamija, të ban me lanë Kuranin, agjinesën, të lamen e të tjera*. Një nga myderizat e Tiranës sajoi edhe një vjershë në turqisht ku thuhej: *Tirande vardër ej babam, i a dinçei tahsin ider*.<sup>28</sup> Në rrugët e Tiranës, fëmijët ju bërtisnin “shqiptarëve” ‘*Ngordhi shqipja jahu!*’ Ndërsa “halldupët” këndonin: *Gjithë të zezat i kam punue / por shqip shyqyr s’kam këndue*.<sup>29</sup> Biles katunaria e Tiranës e cila ishte urdhëruar nga Xhon Turqit e Tiranës për të

<sup>24</sup> Kemal H. Karpat, *The Politicization of Islam, Reconstructing Identity, State, Faith, and Community in the Late Ottoman State*, Oxford University Press, New York, 2001, 335 – 345

<sup>25</sup> Ibid. 342

<sup>26</sup> Mehdi Frasheri, *Problemet Shqiptare*, Liria, 49 – 54

<sup>27</sup> Dalliu. 32 – 35

<sup>28</sup> Dalliu. 28 përkthimi: *në Tiranë or bab ka njerëz që duan me na nxjerr nga dini*.

<sup>29</sup> Ibid. 8

vrarë “kaurët shqiptarë” kur del në qytet dhe takojnë Refik Bej Toptanin e pyesin të habitur: - *zotni, po na thonë se jeni ba shqiptar.*<sup>30</sup>

Problemin e të imagjinuarit të vetes si *shqiptar* duket që e kanë patur edhe më të madh të krishterët e Shqipërisë. Në një letër që Kostandin Kristoforidhi i dërgon Nikolla Naços në vitin 1888, ai i tregonte këtij të fundit që në Shqipëri shumica e njerëzve nuk donin të bëheshin shqiptarë. Ai tregon që në mesin e Turqve Muhamedanë kishte disa që kishin dëshirë për të zhvilluar gjuhën e tyre. Në dallim nga të krishterët, muslimanët frikësoheshin se një ditë që Evropa do ta dëbonte Turqinë drejt Azisë, këta donin t'i provonin asaj se janë të ndryshëm nga turqit, në mënyrë që të mos dëboheshin nga Ballkani. Por kështu mendonte vetëm gjysma e turko – shqiptarëve. Ndërsa mesin e “të kërshterët” vetëm 1 në 10 vetë donte të bëhej shqiptar. Kjo për arsyen se “të kërshterët”, dhe në veçanti kleri dhe të pasurit flisnin greqisht dhe shpresonin që një ditë vendin ta merrte Greqia dhe këta të merrin pronat e muhamedanëve, ndërsa turqit e Shqipërisë të pësonin fatin e turqve të Bosnjes, Bullgarisë dhe Thesalisë.<sup>31</sup>

Mosnjohjen e konceptit të *shqiptarisë* e rrëfejnë shumë intelektualë nacionalistë shqiptarë në kujtimet e tyre. Dom Ndoc Nikaj tregon në kujtimet e tija se fanatizma fetare i kishte bërë ‘*muslimant... të lidhur me rrajë me besimin muhametan qi nuk e dalloshin dot në kujtim se shkputja nga sundimi i Sulltanit ishte sikur mohimi i besimit të tyne... Shqyphtar n’at kohë, prej të shumve, ishte një fjalë qi i pershtatej vetëm Krishtianve.*’<sup>32</sup> Por ndjesia që njerëzit nuk ishin një komb ka qënë shumë e madhe edhe vetë në mesin e fiseve katolike, ku mirditasit nuk jepnin e merrnin me malësorët edhe pse ishin të një feje, dhe shumë nga ata konsideronin më të afërt Malin e Zi sesa njëri tjetrin.<sup>33</sup> Këtë fakt e tregon edhe Eqerem Bej Vlora i cili tregon se:

*botëkuptimi i shumicës dërrmuese të shqiptarëve në vitet 1900 deri 1906 ka qenë për të ardhur keq. Askush nuk e ndjente veten pjesëtar të një populli: kudo që të ishte popullsia ndahej në dy kampe, të ndara e të prera si me thikë. Në njërin bënin pjerë ato tre të kartërta që pyetjes se çfarë ishin, i përgjigjeshin ‘tyrk elhamdyllillah’ (turk, i qofshim falë Zotit)... çereku tjetër, shqiptarët ortodoksë dhe hera herë, (por rrallë) edhe katolikë quheshin gjaurr (kaurrë), emërtim që jo vetëm i përçmonte, por edhe i*

<sup>30</sup> Ibid. 33

<sup>31</sup> AQSH, f.29, D.1. *Leter e Kostandin Kristoforidhit Nikolla Naços, 1888, 24 – 25*

<sup>32</sup> Dom Ndoc Nikaj, *Kujtime te një jetes se kalueme*, Plejad, 2003, 74

<sup>33</sup> Ibid. 49 – 77

*ndante nga tërësia e popullit shqiptar, si një element i ndryshëm, madje, do të thosha i huaj.*<sup>34</sup>

Mbi identifikimin e njerëzve në Shqipëri me diçka tjetër nga ‘shqiptari’ e tregon edhe personi që shkruante me pseudonimin Lap Martallozi në gazetën “Drita” të Sofjes në vitin 1908. Shkruesi në fjalë që sulmonte politikat osmane në Shqipëri ndër të tjera ironizon edhe mënyrën sesi njerëzit mësoheshin nëpër shkolla. Kështu ai tregon se nëpër meqtepe, shqiptarëve u mësonin që sulltanët turq ishin të shenjtë dhe janë dërguar në kahuristanë për të bërë feth nga Allahu, se “Skënderbeu sqe tjetër përveç se një hajdut”, se hoxhët kishin gjetur në një qitap arabisht që tregonte që shqiptarët ishin arabë që një mijë e një e treqint vjet më parë iu zemëruan halifesë hazretit Ymer dhe u bënë muhaxhirë në Shqipëri.<sup>35</sup> Lap Martallozi tregon se i njëjti problem ekzistonte edhe nëpër *skolitë* e grekut, ku njerëzia mësonte që “gjith njerziti e mbëdhenj janë grekë, le Filipi, Leka i madh, Batlemeu, Pirua dhe Skënderbeu, po aq edhe Krishti”.<sup>36</sup>

Problemi i të ndryshuarit të identitetit të *osmanllive* në shqiptarë tregohet në mënyrë shumë origjinale nga një letër që Kostandin Kristoforidhi i dërgon Lef Nosit në 23 Kallnur 1909 nga qyteti i Durrësit. Në këtë letër, Kostandini rrëfen se durrsakët, jo vetëm që refuzonin të mësojnë të shkruajnë gjuhën me gërma latine, por thotë se:

*Myslimanët prap as ta nëgjojnë emnin Shqiptar e fjalën Gjuha shqip nuk dunë; kaq shumë i ka myt fanatizma e xhonturklluku; kan ideen se gjith klubet shqiptar qi jan sot, kane mrena njerzë të pa bes hajdutë e bukshkal qi dunë me u damun më yte nga Osmanlli qi na ka dhan këtë liri; t’ishin shqiptar thonë ato atëhere gjante shqipe e ta shkruine me shkronja Tyrkshe e jo me shkronja latinshe.*<sup>37</sup>

Mungesën e “shqiptarit” në qytetin e Durrësit në vitin 1912 e tregon edhe Mustafa Kruja në shkrimin “*Shqiptari*” i 1912 e shqiptarizma në qarkun e Durrsit” ku ai tregon që në Durrës ka njohur vetëm “dhetë shqiptarë”. Ndërsa muslimanët e ndjenin veten turq, të krishterët ortodoksë besonin se “e vetmia rrugë shpëtimi e lumnije për të ishte helenizma”.

<sup>34</sup> Eqrem bej Vlora: “KUJTIME”, “Shtëpia e botimit dhe e komunikimit”, 2003, 151 - 152

<sup>35</sup> Lap Martallozi, *Liria dhe zgjedha*, Drita, nr. 96, 15 january 1908, Sofia

<sup>36</sup> Ibid

<sup>37</sup> AQSH, F. 32, D. 55, Leter of Kristoforidhi to Lef Nosi, 23 Kallnuer 1909

Sipas Krujës, shqiptari mysliman nuk e ndjente “zanin e gjakut” dhe rretherrrotull shihte veçse “*turk dhe kaurr*”, dhe për të:

*Kaurri ma i keq, ma i egri për ta asht shqyptari mysliman, ai qi don shqipen e Shqipnini. Ky i ka shitun Nemces ase Itales, po sidomos Nemces, mish e shpirt e Atdhe! Këtë s'ka për t'a lanë toka mbrenda, ka për të dalë lugat. Ky asht bamë kaurr me fe e me zakone. Mos të kishte frikë kishte me ndërrue fesin e qeleshen me kapelë e kishte me zblue gruen e me dalë me të alla braca rrugve të qytetit. Shqiptar vec! Ah ky qafir i vulosun me vulën e Nemces si kualt e fushës për do pare të shkreta, ky tradhtuer i Baba-Dauletit, qi s'ka as fe, as nderë, qi me e lanë kush, ruejna Zot, s'kishte me i a përtue m'u martue bash me të motrën!*<sup>38</sup>

Sejfi Vllamasi tregon në kujtimet e tij që problemet e shqiptarisë në vigjilje të krijimit të shtetit kombëtar ishin të kudondodhura. Ndasia ekzistonte si në veri dhe në Shqipërinë e Mesme ku muhamedanët ishin pro-Turqisë, katolikët e Malësisë së Madhe merrnin anën e Malit të Zi dhe po ashtu në jug me vorio-epiriotët. Vllamasfi rrëfen se ‘populli i Shqipërisë së Mesme me një karakter muskular dhe thellësisht fetar’ jo vetëm që nuk kishte ndërgjegje kombëtare ose shumë pak të zhvilluar, por patriotët i konsideronte si *të pafe, të pamoral dhe tradhëtarë*.<sup>39</sup>

Problemi i *konvertimit të osmanllive në shqiptar* nuk ishte vetëm në Shqipërinë Muslimane. Nathalie Clayer rrëfen që “kriza e shqiptarisë” ekzistonte edhe në Korçë në mesin e të krishterëve, ku ajo tregon se ‘sipas konsullit austro-hungarez, në dimër të viti 1909, “partia shqiptare” në këtë qytet kishte në gjirin e saj njëqindpesëdhjetë familje, ndër të cilat ato të Kosturit, të Bimblit dhe të Gramenove, si edhe rreth dyqind familje vllehe. Ndërsa “Partia greke” që ishte kundërshtarë e saj ishte shumë më e fortë. Ajo përmbledhonte afërsisht dymijë familje shqiptare nga Korça dhe katërqind familje vllehe nga Voskopoja, Moskopolisi i vjetër”.<sup>40</sup> Problemet e Korçës i tregon edhe më qartë Nikolla Zoi, i cili shkruante se ortodoksët e Korçës, që ishin shumica “grekë”, akuzonin ata që bëheshin “shqiptarë” si njerëz që ishin kthyer në *myslimanë* apo në *turq*.<sup>41</sup> Rasti i Petro Nini Luarasit,

<sup>38</sup> Mustafa Kruja, “*Shqiptari i 1912 e shqiptarizma në qarkun e Durrsit*”, Shejzat – Shtatuer – Dhetuer 1972, fq. 313 – 319

<sup>39</sup> Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike ne Shqiperi*, Neraida, 2000. 99 – 117

<sup>40</sup> Nathalie Clayer, *Aux origines du nationalisme albanais. La naissance d'une nation majoritairement musulmane en Europe*, Paris, Karthala/CERI, coll. « Recherches internationales », 2007. 657 – 658

<sup>41</sup> Nikolla Zoi (2000), *Nje faqe historie*, Korçe, 47

të cilin Mitropoliti i Kosturit e akuzoi si ‘*mason dhe protestant*’, dhe e ç’kishëroi<sup>42</sup>, kur ai nisi t’u mësojë fshatarëve të Luarasit sesi të shkruanin shqip, tregon për vështirësinë e madhe që haste përpara procesi i konvertimit të osmanëve në shqiptarë në fillimin e shekullit të XX-të në Ballkan.

Lufta ndërmjet konceptit të *turkut* dhe *kaurit* me *shqiptarin e imagjinuar* të Rilindjes u intensifikua edhe më shumë pasi në nëntor të vitit 1912 ish-vilajetet osmane, “Gegëria” dhe “Toskëria” u deklaruan të pavarura nga Perandoria Osmane dhe nën ndikimin e fuqishëm të Fuqive të Mëdha u bashkuan për të krijuar Shqipërinë në 1913. Ndërkohë që një pjesë e madhe e “osmanëve” të “Gegërisë” dhe “Toskërisë”, me në krye Esat Pashën dhe Mahmut Hajret Pashën, luftonin për të mbrojtur *vatanin osman*, deklarimi i pavarësisë nga grupi i nacionalistëve të Ismail Qemalit u prit me habi në të gjithë vendin. Kjo gjë mund të lexohet si në kujtimet e atyre burrave që ne i njohim si *rilindas*, ashtu edhe në telegramet osmanisht të shkëmbyera në këtë kohë brëndapërbrënda rrjetit të nacionalistëve që shpallin pavarësinë. Në telegramet e dërguara në qytete të ndryshme të Shqipërisë, arsyeja e shpalljes së pavarësisë nga Turqia shpjegohej se lidhej me pushtimin serb, dhe se Shqipëria duke shpallur pavarësinë nuk duhej të luftohej nga Serbia.<sup>43</sup> Telegrami që “shqiptarë” si Refik Bej Toptani i çonin Haxhi Ali Elbasanit, që ishte kreu i xhonturqve në Shqipëri, në të cilin e pyesnin nëse një shpallje e këtillë pavarësie mund të sillte ndonjë përfitim,<sup>44</sup> tregon se ndarja e shqiptarëve nga Turqia nuk u bë nga “dëshira” që ndjehej në gjirin e popullit, por nga frika e pushtimit. Hafiz Dalli tregon se populli i Tiranës do të bindej ndaj propagandës së shqiptaristëve për të deklaruar pavarësinë vetëm kur pa se qeveria turke po shkatërrohej nga pushtimi serb dhe nuk kishin ndonjë opsion tjetër. Fjalimi i mëposhtëm i Refik Toptanit mbajtur në Tiranë më 26 Nandor 1912 kur u shpall pavarësia e qytetit tregon arsyen përse Shqipëria po ndahej nga Tyrqinia:

*- O vllazën! Me hidhërim të madh po ju them se e pru puna me u nda prej vllazënve tanë turq dhe me e zbrit bajrakun e atyne që ka value këtu me qindra vjetsh dhe me ngref qeverinë kombëtare e me ngrejtë flamurin e Shqipnisë. Dhantë Zoti e u puqshim kështu si sot gojë ndër gojë që ashtu të mundemi me e ruejtë atdheun tonë*

<sup>42</sup> Petro Nini Luarasi, *Mallkim i Shkronjavet Shqipe dhe çpërfojla e Shqipëtarit*, 1911, 15

<sup>43</sup> Shiko telegramet cuar Elbasanit 15 Vjeshta e Trete 1912, f. 201, telegram 13 Vjeshta e Trete, fq 105, telegrami i dates 14 Vjeshta e Tretë 1912 cuar nga Pegini, në ‘*Dokumenta për Historinë Kombëtare*’ nga Lef Nosi, 1924 - 1925

<sup>44</sup> Ibid. 71

*nga të shkelunit e anmikut. Rroftë Shqipnia në vetë, rroftë vllaznimi, rroftë flamur kombëtar!*<sup>45</sup>

Kryetari i Bashkisë, myftiu dhe kryetari i komisionit për mbrojtje kombëtare të Gjirokastrës, përfaqësuesit e saj që kishin shkuar në Vlorë i autorizonte që *‘të mbronin të drejtat e të Fortës Mbretënië Ottomane e Atdheut tonë të përbashkët.’*<sup>46</sup> Ndërsa në një telegram që Vlora i dërgonte Gjirokastrës, Tepelenës, Delvinës dhe Pogonit në datë 20 Vjeshta e Tretë 1912 shkruan që Qeveria e Përkohshme e Vlonës u shpall nga nevoja. Por *‘lidhjet tona me të Naltin Hilafet të Islamismës do të jenë të patundme deri në Ditën e Kiametit ashtu edhe për vazhdimin e vllaznimit me të Naltën Mbretënië Ottomane nuk do të pushojmë së përpjekuni me sinqeritet edhe Ottomanët sa të jetë jeta do të jenë vllaznit tonë.’*<sup>47</sup> Por në anën tjetër Këshilli Juridik dhe gjykatat e Gjirokastrës dhe Pogonit dënonin këtë akt ndarje nga Perandoria Osmane të kazave të Beratit dhe Gjirokastrës dhe kërkonin ndëshkimin e fajtorëve.<sup>48</sup> Ndërsa Ismail Qemali, në një letër dërguar Esat Pashës dhe forcave mbrojtëse të Shkodrës, shpalljen e pavarësisë e argumenton si formën e vetme për të ruajtur Shqipërinë dhe Islamismën në Evropë në kushtet e krijuara.<sup>49</sup> Por, në kundërshtim me kërkesat e Ismailit, redifët muslimanë të “Gegërisë” vazhduan të mbrojnë vatanin osman dhe, kur Esat Pasha u kthye në Tiranë pas rënies së Shkodrës, uli flamurin “shqiptar” dhe ngriti atë “turk”.<sup>50</sup>

Edhe pse në gusht të vitit 1913 kushtet politike të Shqipërisë ndryshuan, pasi Fuqitë e Mëdha vendosën që të shpallin përfundimisht krijimin e Shqipërisë, nga shkrimet e kohës duket se populli në shumicën e tij nuk e kishte fort të qartë idenë e këtij ndryshimi, i cili duhej të sillte edhe një zhvendosje masive në imagjinatën e njerëzve nga *turq* dhe *kaurë* për në *shqiptarë*. Siç thekson Eric Hobsbawm në librin e tij ‘Kombet dhe nacionalizmi’ për shumicën e italianëve, polakëve dhe popujve të tjerë në Evropë, krijimi i shtetit kombëtar, në gjysmën e dytë të shekullit të XIX, nuk kishte mbështetje të gjerë nga masa, të cilat nuk kuptonin dot se çfarë po ndodhte. Rasti i Massimo D’Azeglios, i cili mendohet të ketë

<sup>45</sup> Dalliu, 88

<sup>46</sup> Dokumenta për historinë kombëtare..., 135 - 136

<sup>47</sup> Ibid. Telegram i datës 20 Vjeshta e Tretë 1912, f. 143 - 144

<sup>48</sup> AQSH, F 486, D. 976, viti 1912, Kopje Vendimi e Keshillit Juridik

<sup>49</sup> Shiko Letër e Ismail Qemalit për Esat Pashën, AQSH, F. 70, D. 15

<sup>50</sup> Dalliu 1930: 93

deklaruar që ‘*Tani që e bëjnë Italianë, duhet të bëjnë italianët*’<sup>51</sup> përsëritet edhe në Shqipëri. Kristo Floqi në numrin e 3-të të gazetës “Përlindja e Shqipnies”, që botohej në Vlorë, pasi ankohet për neglizhencën e njerëzve për këtë ndryshim të madh që kishte ndodhur, pyet ‘*ku janë Shqiptarët që mezi e prisnin këtë ditë të bardhë*’ dhe deklaroi se tani që: ‘*Shqipëria u bë, duhen bërë edhe shqiptarët.*’<sup>52</sup> Por atij dhe veprimtarëve të tjerë të qeverisë së Vlorës iu desh të përballen me një popull që nuk dinte të shkruante gjuhën e tij, por ende komunikonte në gjuhët e mileteve, osmanisht dhe greqisht, që nuk njihte vendimet e Vlorës, dhe më pas atë të Durrësit, dhe që në shumë raste nuk ishte në gjendje të kuptonte se çfarë kishte ndodhur. Konvertimi juridik i osmanëve në shqiptarë u krye në prill 1914, kur Statusi Organik i Qeverisë së Vidit në kapitullin III, pika 1 deklaronte se: ‘*shqiptarë janë të gjithë ata që kanë lindur apo banuar në territorin shqiptar përpara 28 Nëntorit dhe gëzonin në periudhën osmane, nënshtetësinë osmane.*’<sup>53</sup>

Megjithatë, kryengritja e osmanllive të Shqipërisë së Mesme e cila nisi në këtë kohë; deklarimi si osmanë i pjesëmarrësve në të dhe kërkesa e tyre ndaj Fuqive të Mëdha për ribashkimin me Turqinë; rasti i Haxhi Qamilit që i kërkonte Grigor Nosit, që ishte “një copë kaur” që të bëhet “turk”<sup>54</sup>; deklarata e Spiro Milos në 22 shkurt 1914, kur himariotët nuk pranojnë të jetojnë me turko – shqiptarët<sup>55</sup>; dhe shtatë vite më vonë shpallja e Gjon Marka Gjoni në Mirditë, kur mirditorët deklarojnë se: *Nuk e dona ycymetin e Turkijes t’Tirans!*<sup>56</sup>, tregojnë sesa i vështirë dhe i gjatë ka qënë procesi i ndarjes së turkut dhe kaurit nga një perandori në tërheqje, për t’u bashkuar dhe prodhuar shqiptarin e shtet-kombit që ne njohim sot. Ky “shqiptar” që ne njohim sot, dhe që është i ndryshëm nga “turku” për të cilin më fliste plaku pogradecar në vitin 1994, duket të ketë lindur në vitin 1913, kur perënditë e Konferencës së Londrës krijuan Shqipërinë.

<sup>51</sup> Eric J. Hobsbawm, *Nations and nationalism since 1780: programme, myth, reality*, Cambridge University Press, 1992. 44

<sup>52</sup> Kristo Floqi, Gjyqësia në Shqipërië, Përlindja e Shqipnies, nr.3, 2

<sup>53</sup> FO 421 - 293 - Prill 1914, Organic Statute for Albania. 34

<sup>54</sup> Lef Nosi, *Dokumente Historike 1912 – 1918*, Tirane 2007, 321

<sup>55</sup> FO 421 - 292 - viti 1914, Proclamation of Autonomy of Epirus, 116

<sup>56</sup> AQSH, F. Vllazen Kshthenim Mirditë e tan Dukagjini!